REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:138119
Datë:	16.05.2022
Numri i dokumentit:	03013143

Ac.nr.8485/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjykatësin Gëzim Llulluni, në çështjen juridike - përmbarimore të kreditorit: A.H. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, kundër debitorit: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore, për pagesën e borxhit në shumë prej 913.48€, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses së autorizuar të kreditorit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1974/20, i datës 29.01.2021, me datë 10.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit A. H. nga P., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1974/20 i datës 29.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin e atakuar PPP.nr.1974/20 të datës 29.01.2021, në pikën e I të dispozitivit ka vendosur që të: "*Pranohet prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë kundër urdhrit përmbarimor P.nr.1452/20, i Përmbaruesit Privat A.M., i datës 28.05.2020.*" Në pikën II të dispozitivit gjykata ka vendosur që të: *" Shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.1452/20, i Përmbaruesit Privat A.M., i datës 28.05.2020".*

Kundër këtij aktvendimi përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që: Gjykata e Apelit të Aprovoj në tërësi Ankesën e kreditorit dhe ta Shfuqizoj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1974/20, dt. 29.01.2020 dhe ta Detyroj Debitorin që t'ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për Përmbarim gjerë në pagesën definitive të tij, apo çështjen ta kthej në Rivendosje, si dhe të ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

2021:179922

Debitori në anën tjetër e ka pranuar ankesën e kreditorit me dt.22.04.2021 sipas fletëdërgesës për dorëzim personal, por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurës Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim, në bazë të titullit ekzekutiv Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me numër nr.01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020 dhe vendimi nr.303/2020 i datës 19.05.2020, me të cilin debitori është detyruar që kreditorit t'ia paguaj borxhin në emër të dy (2) pagave jubilare në shumën prej 913.48€, dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 28.05.2020, me Urdhër Përmbarimor, nën shenjën P.nr.1452/20 i datës 28.05.2020, ka lejuar përmbarimin duke vlerësuar se vendimi i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me numër nr.01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, i plotëson kushtet si dokument përmbarimor, për ta lejuar përmbarimin.

Kundër Urdhërit Përmbarues mbi lejimin e përmbarimit, përfaqësuesja e autorizuar e debitorit ka paraqitur prapësim me datën 10.06.2020, me propozim që të: aprovohet prapësimi i debitorit QKUK dhe Urdhëri P.nr.1452/20 i datës 28.05.2020 të anulohet dhe Propozimi për Përmbarim të hedhet poshtë si i pa bazë.

Me përgjigje në prapësim të datës 17.09.2020, i autorizuari i kreditorit ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, të vërtetohet Urdhëri Përmbarimor P.nr.1452/20 i datës 28.05.2020 i Përmbaruesit privat A.M. si dhe të detyrohet debitori: Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Prishtinë, që t'ia paguaj borxhin kreditorit, shpenzimet e Avokatit: propozimin për përmbarim 156€, për përgjigje në prapësim 156€, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarimore në përputhje me UA-MD Nr.06/2014, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Urdhëri.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me Aktvendimin e atakuar PPP.nr.1974/20, i datës 29.01.2021, ka vendosur që ta pranoj si të bazuar prapësimin e debitorit i paraqitur kundër Urdhërit mbi lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat A.M., P.nr.1452/20 i datës 28.05.2020, e duke e shfuqizuar Urdhërin përmbarimor P.nr.1452/20 i Përmbaruesit Privat A.M. i datës 28.05.2020.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nga shkresat e lëndës rezulton se prapësimi i debitorit është i bazuar kjo sepse dokumenti përmbarimor me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore në këtë çështje përmbarimore, edhe pse konform nenit 22 të LPP-së përbën titull ekzekutiv-dokument përmbarimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Në rastin konkret gjykata konstatoj se dokumenti përmbarimor me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore në këtë çështje juridike, konkretisht Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020 me të cilin është obliguar debitori që në afat prej (8) ditësh të bëj kompensimin e një page mujore në emër të shpërblimit jubilar për punonjësit që kanë 10 vjet të përvojës së punës në institucione shëndetësore konform nenit 27 të LPP-së, *nuk është i përshtatshëm për përmbarim*, për faktin se *në të nuk është përcaktuar shuma e përmbushjes së detyrimit*.

Në lidhje me këtë duhet theksuar se me nenin 27 par.1 i LPP-së, shprehimisht është përcaktuar se : *" Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit."* Rrjedhimisht, në mënyrë që një dokument përmbarimor të jetë i përshtatshëm për përmbarim duhet që në mënyrë kumulative të plotësohet kushtet e përcaktuara në këtë dispozitë ligjore.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, e duke pasur parasysh shkresat e lëndës, Gjykata gjen se përmbaruesi privat në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar urdhrin për përmbarim në rastin konkret. Sipas kësaj Gjykate, përmbaruesi privat, si organ i shkallës së parë, i cili merr vendime në procedurën përmbarimore, ka pasur për obligim ligjor që të vlerësoj nëse dokumenti përmbarues mbi të cilin është bazuar propozimi për përmbarim i plotëson kushtet ligjore apo jo dhe a është i përshtatshëm për përmbarim. Në rast se përmbaruesi privat do të bënte një vlerësim të tillë, gjykata konsideron se urdhri përmbarimor në rastin konkret nuk do të lëshohej.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se urdhri përmbarimor në këtë çështje juridike përmbarimore është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore të parapara me dispozitat e lartë cekura të LPP-së, të cilat janë të detyrueshme në mënyrë që të zhvillohet procedura e rregullt e përmbarimit.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 22, 27 par. 1 , dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës**,** duke vlerësuar po ashtu se, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se, Vendimi i lëshuar nga Inspektorati i Punës në Prishtinë, me numër nr.01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, në këtë rast nuk është dokument përmbarues, duke mos i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 dhe neni 27 paragraf 1, të LPP-së, ku përcaktohet se: "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ", andaj pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të kreditores se, gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me rastin e aprovimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në bazë të nenit të sipërcituar rezulton se, kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bën dokumentin përkatës përmbarimor të pa përshtatshëm për përmbarim. Me shikimin në shkresat e lëndës konstatohet se, dokumenti përmbarimor-vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës me numër 01nr.21-1715/94 të dt.10.02.2020, në dispozitiv të tij *nuk e përmban shumën e detyrimit*, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se, qëndrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj sipas Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i pati parasysh pretendimet e palës kreditore, se me rastin e ankesës është parashtruar edhe korrigjimi i vendimit dhe arsyeja e mosparaqitjes me propozim është se i njëjti është nxjerrë me pas, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara për shkak se, me shikimin në shkresat e lëndës vërtetohet se, me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbarim i njëjti është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me numër nr.01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për t'u konsideruar dokument i rregullt përmbarimor, për çka edhe fakti se tani është bërë korrigjimi i këtij vendimi, nuk ndikon në ndryshimin e vendimit .

Duke vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit për përmbarim, por vetëm me ankesë ka bashkangjitur korrigjimin e vendimit, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas ankesës së debitorit ka qenë e detyruar qe të veproj konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur, pasi që nuk ka pasur njohuri lidhur me korrigjimin e vendimit përmbarimor, në ndërkohe ka qenë vetë detyrim i palës kreditore e cila ka interes në këtë procedurë, që paraprakisht të bëj edhe precizimin dhe korrigjimin e propozimit për përmbarim. Gjykata e Apelit vlerëson se pala kreditore eventualisht mund të parashtroj propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për t'u konsideruar dokument i rregullt përmbarimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbarimin e propozuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi .

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë, vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8485/21, me datë 10.05.2022

Gjykatësi
Gëzim Llulluni